

**DIREKTIVA 1999/93/CE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E  
KËSHILLIT  
e 13 Dhjetorit 1999, në kuadrin e Komunitetit për nënshkrimin  
elektronik.**

**Përkthim jozyrtar**

*Gazeta Zyrtare L 013 , 19/01/2000 fq. 0012 - 0020*

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

- Duke pasur parasysh Traktatit Themelues të Komunitetit Evropian, në veçanti nenet 47(2), 55 dhe 95 të këtij Traktatit,
- Duke pasur parasysh propozimit të Komisionit <sup>(1)</sup>,
- Duke pasur parasysh opinionin të Komisionit Ekonomik dhe Shoqëror <sup>(2)</sup>,
- Duke pasur parasysh opinionin të Komisionit të Rajoneve <sup>(3)</sup>,
- Duke vepruar në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 251 të Traktatit <sup>(4)</sup>,
- Duke pasur parasysh se:

---

<sup>1</sup> OJ C 325, 23.10.1998, f. 5.

<sup>2</sup> OJ C 40, 15.2.1999, f. 29.

<sup>3</sup> OJ C 93, 6.4.1999, f. 33.

<sup>4</sup> Opinion i Parlamentit Evropian, datë 13 janar 1999 (OJ C 104, 14.4.1999, f. 49), Qëndrim i Përbashkët i Këshillit, datë 28 qershor 1999 (OJ C 243, 27.8.1999, f. 33) dhe Vendim i Parlamentit Evropian, datë 27 tetor 1999 (nuk është botuar ende në Gazetën Zyrtare). Vendim i Këshillit, datë 30 nëntor 1999.

- (1) Më datë 16 prill 1997 Komisioni i ka paraqitur Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social dhe Komitetit të Rajoneve, një Komunikatë mbi një Nismë Evropiane për Tregtinë Elektronike;
- (2) Më datë 8 tetor 1997 Komisioni i ka paraqitur Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social dhe Komitetit të Rajoneve, një Komunikatë mbi arritjen e sigurisë dhe besimit në fushën e komunikimit elektronik, drejt një kuadri evropian për nënshkrimet elektronike dhe shifrimin;
- (3) Më datë 1 dhjetor 1997 Këshilli i ka kërkuar Komisionit të paraqesë sa më shpejt, një propozim për një Direktivë të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, për nënshkrimet elektronike;
- (4) Komunikimi dhe tregtia elektronike, kanë nevojë për “nënshkrimet elektronike” dhe shërbimet e lidhura me to, për të mundësuar vërtetimin e të dhënave; rregullat që nuk përputhen me njohjen ligjore të nënshkrimeve elektronike dhe akreditimin e ofruesve të shërbimit të certifikimit në Shtetet Anëtare të cilat mund të krijojnë një pengesë të ndjeshme për përdorimin e komunikimit elektronik dhe tregtinë elektronike; nga ana tjetër, një kuadër i qartë i Komunitetit në lidhje me kushtet që zbatohen për nënshkrimet elektronike do ta rrisin besimin dhe pranimin e teknologjive të reja, është mirë që legjislacioni i Shteteve Anëtare të mos e pengojë lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve në tregun e brendshëm;
- (5) Duhet nxitur përputhja në funksionim e produkteve të nënshkrimit elektronik; në përputhje me nenin 14 të Traktatit, tregu i brendshëm përfshin një zonë pa kufij të brendshëm, në të cilin sigurohet lëvizja e lirë e mallrave; duke përmbushur kërkesat thelbësore që janë specifike për produktet e nënshkrimeve elektronike për të siguruar lëvizjen e lirë në tregun e brendshëm dhe për të ngritur besimin te nënshkrimet elektronike, pa zhvleftësuar Rregulloren e Këshillit (KE) nr 3381/94, më 19 dhjetor 1994, “Për krijimin e një regjimi të Komunitetit për mbajtjen nën kontroll të

eksportit të mallrave me përdorim të dyfishtë <sup>(1)</sup> dhe Vendimin e Këshillit 94/942/CFSP, datë 19 dhjetor 1994, "Për veprimin e përbashkët të miratuar nga Këshilli për mbajtjen nën kontroll të eksportit të mallrave me përdorim të dyfishtë <sup>(2)</sup>;

- (6) Kjo Direktivë nuk harmonizon ofrimin e shërbimeve në lidhje me ruajtjen e informacionit konfidencial kur këto shërbime mbulohen nga dispozitat kombëtare që kanë të bëjnë me politikën publike ose sigurinë publike;
- (7) Tregu i brendshëm siguron lëvizjen e lirë të personave, si rezultat i së cilës qytetarët dhe personat me banim në Bashkimin Evropian gjithnjë e më shumë u duhet të kenë të bëjnë me autoritetet në Shtete Anëtare të tjera, krahas vendit anëtar ku banojnë vetë; në lidhje me këtë, mundësia e përdorimit të komunikimit elektronik do të ishte me vlerë të madhe;
- (8) Zhvillimi i vrullshëm teknologjik dhe natyra globale e internetit, kërkojnë një qasje e cila është e hapur ndaj teknologjisë dhe shërbimeve të ndryshme të afta të vërtetojnë origjinalitetin e të dhënave në mënyrë elektronike;
- (9) Nënshkrimet elektronike do të përdoren në një shumëllojshmëri të madhe rrethanash dhe aplikacionesh, duke çuar në një gamë të gjerë shërbimesh dhe produktesh të reja që kanë lidhje me nënshkrimet elektronike ose që i përdorin këto të fundit; është mirë që përkufizimi i produkteve dhe i shërbimeve të tilla të mos kufizohet me lëshimin dhe menaxhimin e certifikatave, por të përfshijë edhe çdo shërbim dhe produkt tjetër i cili përdor ose mbështetet te nënshkrimet elektronike siç janë : shërbimet e regjistrimit, shërbimet e regjistrimit të orarit, shërbimet e adresarëve, shërbimet e kompjuterizuara ose shërbimet e konsultave të lidhura me nënshkrimet elektronike;
- (10) Tregu i brendshëm u mundëson ofruesve të shërbimit të certifikimit, të zhvillojnë aktivitetet e tyre ndërkufitare me qëllim rritjen e konkurrencës

---

<sup>1</sup> OJ L 367, 31.12.1994, f. 1. Rregullore e ndryshuar nga Rregullorja (EC) Nr 837/95 (OJ L 90, 21.4.1995, f. 1).

<sup>2</sup> OJ L 367, 31.12.1994, f. 8. Vendim i ndryshuar nga Vendimi 99/193/CFSP (OJ L 73, 19.3.1999, f. 1).

për t'u ofruar kështu mundësi të reja klientëve e bizneseve në shkëmbimin e informacionit dhe mënyrën, e sigurte elektronike, pa u penguar nga kufijtë; për të nxitur një ofrim të shërbimeve të komunikimit përmes rrjeteve të hapura në mbarë Komunitetin, është mirë që ofruesit e shërbimeve të certifikimit, t'i ofrojnë shërbimet e tyre pa autorizim paraprak; autorizim paraprak do të thotë jo vetëm çdo leje përmes së cilës ofruesi i shërbimeve të certifikimit duhet të marrë një vendim nga autoritetet kombëtare përpara se t'i lejohej të ofrojë shërbimet e veta të certifikimit, por edhe çdo masë tjetër me të njëjtin efekt;

- (11) Skemat vullnetare të akreditimit, të cilat synojnë në rritjen e nivelit të ofrimit të shërbimeve, mund t'u sigurojë ofruesve të shërbimeve të certifikimit, kuadrin e duhur për t'i zhvilluar më tej shërbimet e tyre me qëllim arritjen e atij nivel besimi, sigurie dhe cilësie që kërkon tregu në zhvillim e sipër; është mirë që skema të tilla të nxisin zhvillimin e përvojës më të mirë tek ofruesit e shërbimeve të certifikimit; është mirë që ofruesit e shërbimeve të certifikimit, të lihen të lirë që të marrin pjesë dhe të përfitojnë nga skema të tilla akreditimi;
- (12) Shërbimet e akreditimit, mund të ofrohen ose nga një subjekt publik, ose nga një subjekt juridik apo person fizik, nëse krijohen sipas ligjit të vendit; ndërsa Shtetet Anëtare, është mirë të mos i ndalojnë ofruesit e shërbimeve të certifikimit jashtë skemave vullnetare të akreditimit; duhen siguruar që skema të tilla akreditimi të mos e ulin konkurrencën për shërbimet e certifikimit;
- (13) Shtetet Anëtare mund të marrin vendim për mënyrën se si të sigurojnë mbikëqyrjen e përmbushjes së dispozitave të parashikuara në këtë Direktivë; kjo Direktivë nuk e pengon krijimin e sistemeve të mbikëqyrjes të mbështetur në sektorin privat; kjo Direktivë nuk i detyron ofruesit e shërbimeve të certifikimit të paraqesin kërkesë për t'u mbikëqyrur tek asnjëra prej skemave të aplikueshme të akreditimit;

- (14) Është e rëndësishme të vendoset një ekuilibër midis nevojave të konsumatorëve dhe të bizneseve;
- (15) Shtojca III mbulon kërkesat për aparatura të sigurta në krijimin e nënshkrimeve për të siguruar funksionimin e avancuar të nënshkrimeve elektronike ; ai nuk e mbulon të gjithë mjedisin e sistemit në të cilin funksionojnë këto aparatura; funksionimi i tregut të brendshëm i kërkon Komisionit dhe Shteteve Anëtare të veprojnë me shpejtësi për t'u dhënë mundësi organeve të ngarkuara në vlerësimin e zbatimit nga ana e aparaturave të nënshkrimeve të sigurta të kërkesave të Shtojcës III që të përcaktohen; për të përmbushur nevojat e tregut, vlerësimi i përmbushjes së kërkesave ligjore duhet të realizohet në kohë dhe me efikasitet;
- (16) Kjo Direktivë ndihmon në përdorimin dhe njohjen ligjore të nënshkrimeve elektronike brenda Komunitetit; nuk nevojitet një kuadër rregullator për nënshkrimet elektronike që përdoren vetëm brenda sistemeve, të cilat mbështeten në aktmarrëveshjen vullnetare në kuadër të së drejtës private midis një numri të përcaktuar pjesëmarrësish; është mirë të respektohet liria e palëve për të rënë në marrëveshje mes syresh, në lidhje me termat dhe kushtet, që të pranojnë të dhëna të nënshkruara në formë elektronike, për aq sa lejohet nga ligji vendas; është mirë të pranohet efikasiteti ligjor i nënshkrimeve elektronike, të cilat përdoren në sisteme të tilla dhe pranimi i tyre si provë gjyqësore;
- (17) Kjo Direktivë nuk kërkon të harmonizojë rregullat kombëtare të cilat kanë të bëjnë me legjislacionin për kontratat, me hartimin dhe realizimin e kontratave, ose formalitete të tjera të natyrës jo kontraktuese , të cilat kanë të bëjnë me nënshkrimet, ,për këtë arsye, dispozitat që kanë të bëjnë me efektin ligjor të nënshkrimeve elektronike, është mirë të mos zhvleftësojnë kërkesat ligjore të cilat lidhen me formën, të parashikuara në ligjin e vendit për lidhjen e kontratave ose rregullave që përcaktojnë nëse është lidhur apo jo një kontratë;

- (18) Ruajtja dhe kopjimi i të dhënave për krijimin e nënshkrimeve mund të përbëjë një kërcënim ndaj vlefshmërisë ligjore të nënshkrimeve elektronike;
- (19) Nënshkrimet elektronike, do të përdoren në sektorin publik brenda administratave kombëtare , administratës së Komunitetit dhe gjatë komunikimeve midis këtyre administratave, qytetarëve e subjekteve ekonomike, si për shembull : në sistemet e prokurimeve publike, në tatim-taksat, në sigurimet shoqërore, në shëndetësi dhe në drejtësi;
- (20) Kriteret e harmonizuara të cilat lidhen me efektet ligjore të nënshkrimeve elektronike ,do të ruajnë një kuadër ligjor koherent në mbarë Komunitetit; ligji kombëtar parashikon kërkesat e ndryshme për vlefshmërinë ligjore të nënshkrimeve të hedhura me dorë; ndërkohë që certifikatat mund të përdoren për të konfirmuar identitetin e një personi që hedh firmë në formë elektronike; nënshkrimet elektronike të përparuara , të cilat mbështeten në certifikatat e kualifikuara, synojnë një nivel më të lartë sigurie; nënshkrimet elektronike të përparuara të cilat mbështeten në një certifikatë të përparuara dhe të cilat krijohen përmes një aparature krijimi të sigurt nënshkrimi , mund të konsiderohen si të barasvlershme ligjërisht me nënshkrimet e hedhura me dorë, vetëm nëse përmbushen kërkesat ligjore për nënshkrimet e hedhura me dorë;
- (21) Për të ndihmuar në pranimin e përgjithshëm të metodave elektronike të vërtetimit, duhet treguar kujdes që nënshkrimet elektronike të mund të përdoren si prova gjyqësore në proceset ligjore në të gjitha Shtetet Anëtare; është mirë që njohja ligjore e nënshkrimeve elektronike të mbështeten në kritere objektive dhe të mos lidhet me autorizimin e ofruesit të shërbimeve të certifikimit të përfshirë në proces; ligji kombëtar, rregullon sferat ligjore në të cilat mund të përdoren dokumentet elektronikë dhe nënshkrimet elektronike; kjo Rregullore nuk zhvleftëson kompetencën e një gjykate kombëtare për të marrë vendim në lidhje me përmbushjen e kërkesave të

- kësaj Direktive dhe, nuk prek rregullat kombëtare në lidhje me marrjen në shqyrtim në mënyrë të papenguar të provave gjyqësore;
- (22) Ofruesit e shërbimeve të certifikimit të cilët i ofrojnë publikut shërbime certifikimi, u nënshtrohen rregullave kombëtare për përgjegjësinë ligjore;
- (23) Zhvillimi i tregtisë elektronike ndërkombëtare kërkon masa organizuese ndërkufitare, të cilat përfshijnë vende të treta; për të siguruar funksionimin e përputhshmërisë në nivel global, mund të ndihmojnë aktmarrëveshjet për rregullat shumëpalëshe me vendet e treta, me qëllim njohjen e ndërsjellë të shërbimeve të certifikimit;
- (24) Për të rritur besimin e përdoruesve të komunikimit elektronik dhe tregtisë elektronike, ofruesit e shërbimeve të certifikimit duhet të respektojnë legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave si dhe jetën private të individëve;
- (25) Është mirë që dispozitat për përdorimin e pseudonimeve në certifikata të mos i pengojnë Shtetet Anëtare të kërkojnë identifikimin e personave sipas ligjit të Komunitetit ose të vendit;
- (26) Duhet miratuar masat e nevojshme për vënien në zbatim të kësaj Direktive, në përputhje me Vendimin e Këshillit 1999/468/KE, e 28 qershorit 1999 ku, parashikohen procedurat për ushtrimin e kompetencave zbatuese që jep Komisioni <sup>(1)</sup>;
- (27) Dy vjet pas vënies në zbatim, Komisioni do të kryejë një rishikim të kësaj Direktive në mënyrë që të kujdeset duke pasur parasysh që përparimi i teknologjisë ose ndryshimet në mjedisin ligjor të mos kenë krijuar pengesa për arritjen e synimeve të parashkruara në këtë Direktivë; është mirë të shqyrtohen të lidhura rrjedhojat e fushave teknike dhe t'i paraqitet një raport Parlament Evropian dhe Këshillit në lidhje me këtë temë;
- (28) Në përputhje me parimet e subsidiaritetit dhe të proporcionalitetit për Denatën të parashikuar në nenin 5 të Traktatit, objektivi i krijimit të një

---

<sup>1</sup> OJ L 184, 17.7.1999, f. 23.

kuadri ligjor të harmonizuar për ofrimin e nënshkrimeve elektronike dhe shërbimeve të lidhura me to nuk mund të arrihet nga Shtetet Anëtare dhe për rrjedhojë, mund të arrihet më mirë nga Komuniteti; kjo Direktivë nuk shkon përtej kufirit të asaj që është e nevojshme për të arritur këtë objektiv,

## MIRATOJNË KËTË DIREKTIVË:

### **Neni 1**

#### **Objekti**

Qëllimi i kësaj Direktive është që të ndihmojë në përdorimin dhe njohjen ligjore të nënshkrimeve elektronike. Në të përcaktohet kuadri ligjor për nënshkrimet elektronike dhe disa shërbime të caktuara të certifikimit për të garantuar funksionimin e duhur të tregut të brendshëm.

Në të nuk trajtohen aspekte të cilat kanë të bëjnë me lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratave apo me detyrimet e tjera ligjore vetëm në raste kur ka kërkesa ligjore për formën të cilat përcaktohen nga ligji kombëtar ose ligji i Komunitetit. Kjo Direktivë nuk prek rregullat dhe kufizimet e përmbajtura në ligjin kombëtar ose të Komunitetit për rregullimin e përdorimit të dokumenteve.

## Neni 2

### Përkufizime

Për qëllimin e kësaj Direktive:

1. “nënshkrime elektronike” janë të dhëna në formë elektronike, të cilat u bashkëlidhen ose shoqërohen logjikisht me të dhëna të tjera elektronike , të cilat shërbejnë si metodë vërtetimi;
2. “nënshkrim elektronik i avancuar” është nënshkrimi elektronik i cili përmbush kërkesat e mëposhtme:
  - a. lidhet me nënshkruesin në mënyrë unike;
  - b. ka aftësinë të identifikojë nënshkruesin;
  - c. krijohet me mjete të cilat mund t’i mbajë nën kontroll vetëm nënshkruesi dhe;
  - d. lidhet me të dhënat me të cilat ka të bëjë në mënyrë të atillë, që të mund të jetë i diktueshëm çdo ndryshim i mëpasshëm i këtyre të dhënave;
3. “nënshkruesi” është një person i cili disponon një mjet të krijimit të nënshkrimeve, i cili vepron ose në emër të vet, ose në emër të personit fizik apo subjektit juridik që përfaqëson;
4. “të dhënat krijuese të nënshkrimeve” janë të dhëna unike, si për shembull kode ose çelësa kriptografikë privatë, të cilat përdoren nga nënshkruesi për të krijuar një nënshkrim elektronik;
5. “aparatura e krijimit të nënshkrimeve” është software ose hardware i konfiguruar, i cili përdoret për të vënë në zbatim të dhënat krijuese të nënshkrimeve;
6. “mjet i sigurt i krijimit të nënshkrimit” është aparatura e krijimit të nënshkrimeve, e cila përmbush kërkesat e parashikuara në Shtojcën III;

7. “kode kontrolluese te nënshkrimeve” janë të dhënat si për shembull, kode ose çelësa publikë kriptografik, të cilat përdoren për të verifikuar nënshkrimin elektronik;
8. “mjetet e verifikimit të nënshkrimeve” është hardware ose software i konfiguruar, i cili përdoret për të vënë në zbatim kodet verifikuese të nënshkrimeve;
9. “certifikata” është një vërtetim elektronik, i cili bën lidhjen midis të dhënave verifikuese të nënshkrimit me një person dhe konfirmon identitetin e këtij personi;
10. “certifikata e kualifikuar” është certifikata e cila përmbush kërkesat e parashikuara në Shtojcën I dhe ofrohet nga një ofrues i shërbimeve të certifikimit, i cili përmbush kërkesat e parashikuara në Shtojcën II;
11. “ofruesi i shërbimeve të certifikimit” është një subjekt juridik ose person fizik, i cili lëshon certifikata ose ofron shërbime të tjera të lidhura me nënshkrimet elektronike;
12. “produkti i nënshkrimit elektronik” është një mjet i patrupëzuar ose i trupëzuar, ose pjesë përbërëse e një mjeti të tillë, të cilat përdoren nga ofruesit e shërbimeve të certifikimit, për ofrimin e shërbimeve të nënshkrimeve elektronike ose të cilat përdoren për krijimin, ose verifikimin e nënshkrimeve elektronike;
13. “akreditimi vullnetar” është leja e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet konkrete të ofrimit të shërbimeve të certifikimit , e cila jepet sipas kërkesës së ofruesit të shërbimeve të certifikimit në fjalë ,nga organi publik ose privat i ngarkuar me përcaktimin dhe mbikëqyrjen e këtyre të drejtave dhe detyrimeve, në rastet kur ofruesi i shërbimeve të certifikimit, nuk ka kompetencë të ushtrojë të drejta që rrjedhin nga leja ,derisa të ketë marrë vendimin nga organi në fjalë.

### Neni 3

#### Hyrja në treg

1. Shtetet Anëtare nuk ia nënshtrojnë ofrimin e shërbimeve të certifikimit kërkesës për autorizim paraprak.
2. Pa zhvleftësuar dispozitat e paragrafit 1, Shtetet Anëtare mund të fusin në përdorim ose të mbajnë skema vullnetare të akreditimit, me synim rritjen e nivelit të ofrimit të shërbimeve të certifikimit. Të gjitha kushtet e lidhura me skema të tilla, duhet të jenë objektive, transparente, proporcionale dhe mosdiskriminuese. Shtetet Anëtare nuk mund ta kufizojnë numrin e ofruesve të akredituar të shërbimeve të certifikimit për arsye të cilat bien ndesh me objektin e kësaj Direktive.
3. Çdo Shtet Anëtar kujdeset për krijimin e një sistemi të përshtatshëm, i cili mundëson mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve të certifikimit të krijuar në territorin e vet dhe, të cilët lëshojnë certifikata të kualifikuara për publikun.
4. Konformizmi i aparaturave të sigurta në krijimin e nënshkrimeve me kërkesat e parashikuara në Shtojcën III, përcaktohet nga organet e përshtatshme publike ose private të caktuara nga Shtetet Anëtare. Sipas procedurës së parashikuar në nenin 9, Komisioni vendos kriteret për Shtetet Anëtare për të marrë vendim nëse duhet caktuar apo jo një organ si i tillë. Vendimi në lidhje me përmbushjen e kërkesave të parashikuara në Shtojcën III i marrë nga organet e përmendura në nënparagrafin e parë, pranohet nga të gjitha Shtetet Anëtare.
5. Në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 9, Komisioni mund të vendosë dhe të publikojë numra reference të standardeve të pranuar gjerësisht për produktet e nënshkrimeve elektronike në *Gazetën Zyrtare të Komunitetit Evropian*. Shtetet Anëtare prezumojnë se ekziston përmbushja e kërkesave të parashikuara në Shtojcën II, pika (f), dhe në Shtojcën III kur një produkt i nënshkrimeve elektronike i përmbush këto standarde.

6. Shtetet Anëtare dhe Komisioni, punojnë së bashku për të nxitur zhvillimin dhe përdorimin e aparaturave verifikuese të nënshkrimeve në bazë të rekomandimeve për verifikimin e sigurt të nënshkrimeve të parashikuara në aneksin IV dhe në interes të klientit.

7. Shtetet Anëtare mund t'i përdorin nënshkrimet elektronike në sektorin publik duke iu nënshtruar kërkesave ligjore shtesë. Këto kërkesa janë objektive, transparente, proporcionale dhe mos-diskriminuese dhe kanë lidhje vetëm me karakteristikat konkrete të aplikimit në fjalë. Këto kërkesa nuk mund të përbëjnë pengesë për shërbimet ndërkufitare për qytetarët.

#### **Neni 4**

#### **Parimet e tregut të brendshëm**

1. Secili Shtet Anëtar zbaton dispozitat kombëtare të cilat i miraton sipas kësaj direktive, për certifikimin e ofruesve të shërbimeve të certifikimit, të themeluar në territorin e vet dhe për shërbimet e ofruara prej tyre. Vendet Anëtare nuk mund ta kufizojnë ofrimin e shërbimeve të certifikimit me origjinë nga një vend anëtar tjetër në fushat e mbuluara nga kjo direktivë.

2. Shtetet Anëtare kujdesen që produktet e nënshkrimeve elektronike të cilat përmbushin dispozitat e kësaj direktive të lejohen të qarkullojnë lirshëm në tregun e brendshëm.

## Neni 5

### Efektet ligjore të nënshkrimeve elektronike

1. Shtetet Anëtare kujdesen që nënshkrimet e avancuara elektronike të cilat mbështeten në një certifikatë të kualifikuar dhe të cilat krijohen me anë të një aparati të krijimit të nënshkrimeve të sigurta:

(a) të përmbushin kërkesat ligjore të një nënshkrimi në lidhje me të dhënat në formë elektronike në të njëjtën mënyrë siç i përmbush këto kërkesa ligjore edhe nënshkrimi i hedhur me dorë në lidhje me të dhënat në letër; dhe

(b) të jenë të pranueshme si provë gjyqësore në proceset ligjore.

2. Shtetet Anëtare kujdesen që nënshkrimin elektronik të mos i mohohet fuqia ligjore dhe pranueshmëria si provë gjyqësore në proceset ligjore vetëm për arsye se është:

(a) në formë elektronike, ose

(b) jo i mbështetur në një certifikatë të kualifikuar, ose

(c) jo i mbështetur në një certifikatë të kualifikuar e lëshuar nga një ofrues i

a kredituar i shërbimeve të certifikimit, ose

(d) jo i krijuar përmes një aparature të sigurt të krijimit të nënshkrimeve

## Neni 6

### Përgjegjësia ligjore

1. Shtetet Anëtare kujdesen që gjatë lëshimit të një certifikate si certifikatë e kualifikuar për publikun ose, gjatë garantimit të një certifikate të tillë për publikun ofruesi i shërbimeve të certifikimit, duhet të mbajë përgjegjësi ligjore për dëmin e shkaktuar çdo subjekti juridik ose personi fizik, që mbështetet tek certifikata në fjalë në mënyrë të arsyeshme:

(a) në lidhje me saktësinë në kohën e lëshimit të gjithë informacioneve që përmban certifikata e kualifikuar dhe në lidhje me faktin që certifikata përmban të gjitha të dhënat e parashikuara për një certifikatë të kualifikuar;

(b) për të garantuar që në kohën e lëshimit të certifikatës, nënshkruesi i identifikuar në certifikatën e kualifikuar ka mbajtur të dhëna krijuese të cilat u korrespondojnë të dhënave verifikuese të nënshkrimit që jepen ose identifikohen në certifikatë;

(c) për të garantuar që të dhënat krijuese dhe të dhënat verifikuese të nënshkrimit mund të përdoren në plotësim të njëra-tjetrës kur gjenerohen nga i njëjti ofrues i shërbimeve të certifikimit; me përjashtim të rasteve kur ofruesi i shërbimeve të certifikimit vërteton se nuk ka pasur neglizhencë nga ana e tij.

**2.** Shtetet Anëtare, kujdesen që nënshkrimit elektronik, të mos i mohohet fuqia ligjore dhe pranimi si provë gjyqësore në proceset e tilla vetëm për arsye se është:

(a) në formë elektronike,

(b) jo i mbështetur në një certifikatë të kualifikuar,

(c) jo i mbështetur në një certifikatë të kualifikuar e lëshuar nga një ofrues i akredituar i shërbimeve të certifikimit,

(d) jo i krijuar përmes një aparature të sigurt të krijimit të nënshkrimeve.

**3.** Minimalisht Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që një ofrues i shërbimit të certifikimit i cili ka lëshuar një certifikatë të kualifikuar si certifikate për publikun, të mbajë përgjegjësi për dëmin e shkaktuar ndaj çdo personi juridik ose fizik i cili në mënyrë të arsyeshme mbështetet në certifikatë për mos regjistrimin e revokimit të saj, përveçse kur ofruesi i shërbimit të certifikimit vërteton që nuk ka vepruar me neglizhencë.

4. Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që ofruesi i shërbimit të certifikimit të mund të tregojë në një certifikatë të kualifikuar kufizimet e përdorimit të saj, duke u kujdesur që kufizimet të jenë të dukshme për palët e treta. Ofruesi i shërbimit të certifikimit nuk do të jetë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga përdorimi i certifikatës së kualifikuar kur tejkalojnë kufizimet e saj.

5. Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që ofruesi i shërbimit të certifikimit të mund të tregojë në certifikatën e kualifikuar limitin e vlerës së transaksionit ndaj të cilës mund përdoret certifikata, duke u siguruar që kufizimet të jenë të kuptueshme për palët e treta.

Ofruesi i shërbimit të certifikimit nuk do të mbajë përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga tejkalimi i maksimumit të vlerës së lejuar.

6. Masat e paragrafëve 1 deri 4 nuk duhet të çenojnë Direktivën e Këshillit 93/13/KEE të 5 Prillit 1993 mbi kushtet e pa drejta në kontratat konsumatore (8).

## **Neni 7**

### **Aspekte të Brendshme**

1. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që certifikatat të cilat lëshohen si certifikata të kualifikuara për publikun nga një ofrues i shërbimit të certifikimit me qendër në një shtet të tretë të njihen si juridikisht të barazvlefshme me certifikatat e lëshuara nga një ofrues i shërbimit të certifikimit brenda komunitetit nëse:

(a) ofruesi i shërbimit të çertifikimit plotëson kërkesat e deklaruara në këtë Direktivë dhe është akredituar në bazë të një skeme akreditimi vullnetar në fuqi në një Shtet Anëtar; ose

(b) ofruesi i shërbimit të çertifikimit i themeluar brenda komunitetit i cili plotëson kërkesat e deklaruara në këtë Direktivë garanton që çertifikata; ose

(c) çertifikata ose ofruesi i shërbimit të çertifikimit miratohet në bazë të një marrëveshje bilaterale ose multilaterale midis komunitetit dhe vendeve të treta ose organizatave ndërkombëtare.

**2.** Për të lehtësuar shërbimet e çertifikimit kufitar me vendet e treta dhe njohjen ligjore të nënshkrimeve elektronike me prejardhje nga shtetet e treta, Komisioni duhet të bëjë propozime, kur e sheh të nevojshme, për të arritur implementimin efektiv të standardeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të aplikueshme për shërbimin e çertifikimit. Në veçanti, dhe kur e sheh të nevojshme, duhet t'i parashtroj propozime Këshillit për mandatet e përshtatshme për negocimin e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale me shtetet e treta dhe organizatat ndërkombëtare. Këshilli vendos me shumicë të kualifikuar.

**3.** Kurdoherë që Komisioni informohet për ndonjë vështirësi të hasur nga ndërmarrjet e komunitet në lidhje me hyrjen në tregun e vendeve të treta, ai mundet, nëse e sheh të nevojshme, t'i parashtroj propozime Këshillit për një mandat të përshtatshëm negociimi mbi të drejtat e krahasueshme të ndërmarrjeve të komunitetit në këto shtete. Këshilli do të vendosë me shumicë të kualifikuar.

Masat e marra në vijim të këtij paragrafi nuk duhet të çenojnë detyrimet e komunitetit dhe Shteteve Anëtare në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare përkatëse.

## **Neni 8**

### **Mbrojtja e Të Dhënave**

**1.** Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që ofruesi i shërbimit të certifikimit dhe organet shtetërore përgjegjëse për akreditimin ose mbikëqyrjen të përputhen me kërkesat e formuluar në Direktivën 95/46/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 24 Tetorit 1995 mbi mbrojtjen e të dhënave të individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave (9).

**2.** Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që ofruesi i shërbimit të certifikimit që lëshon certifikata për publikun të mund të mbledhë të dhënat personale vetëm drejtpërsëdrejti nga subjekti i të dhënave, dhe vetëm për sa është e nevojshme për lëshimin dhe mbajtjen e certifikatës. Të dhënat nuk mund të përdoren për asnjë arsye tjetër pa miratimin e shprehur të subjektit të të dhënave.

**3.** Pa çenuar efektin ligjor dhënë pseudonimeve në bazë të lighit vendas, Shtete Anëtare nuk do t'i ndalojnë dhënësve të shërbimit të certifikimit të shënojnë në certifikatë një pseudonim në vend të firmës së emrit.

## **Neni 9**

### **Komiteti**

1. Komisioni do të ndihmohet nga një “ Komitet mbi firmën elektronike” më poshtë cituar si “komiteti”
  
  2. Aty ku i bëhet referim këtij paragrafi do të zbatohet neni 4 dhe 7 i Vendimit 1999/468/KE, duke patur parasysh prej tij masat e nenit 8.
- Periudha e formuluar në nenin 4(3) të Vendimit 1999/4688/KE do të caktohet tre muaj.
3. Komiteti do të miratojë rregullat e proçeurës së tij.

## **Neni 10**

### **Detyrat e komitetit**

Komiteti duhet të sqarojë kërkesat ligjore të parashtruara në Shtojcat e kësaj Direktive, kriteret e përcaktuara në nenin 3 pika 4 dhe standardet e pranuar përgjithësisht për produktet e nënshkrimit elektronik të vendosura dhe publikuara në vijim të nenit 3 pika 5, në përputhje me proçedurën e parashtruar në nenin 9 pika 2.

## **Neni 11**

### **Njoftimi**

1. Shtetet Anëtare e informojnë përmes njoftimeve Komisionin dhe Shtetet Anëtare të tjera për:

- (a) të dhëna për skemat kombëtare vullnetare të akreditimit, përfshirë edhe çdo kërkesë shtesë sipas nenit 3(7);
- (b) emrat dhe adresat e organeve kombëtare përgjegjëse, për akreditimin dhe mbikëqyrjen si edhe, të organeve të përmendura në nenin 3(4);
- (c) emrat dhe adresat e të gjithë ofruesve kombëtarë të akredituar të shërbimeve të certifikimit.

2. Të gjitha informacionet e dhëna sipas paragrafit 1 dhe ndryshimet në lidhje me këto informacione, bëhen me dije nga ana e Shteteve Anëtare në rastin më të parë.

## **Neni 12**

### **Shqyrtimi**

1. Komisioni e shqyrton funksionimin e kësaj direktive dhe i raporton në lidhje me këtë Parlamentit Evropian dhe Këshillit, jo më vonë se më, 19 korrik 2003.

2. Ndër të tjera ky shqyrtim, do të analizojë nëse duhet ndryshuar apo jo objekti i kësaj direktive, në bazë të zhvillimeve teknologjike, ligjore dhe të tregut. Në veçanti, ky raport do të përfshijë një analizë të aspekteve të harmonizimit në bazë të përvojës së fituar. Kur është e nevojshme raporti shoqërohet me propozime legislative.

**Neni 13**  
**Vënia në zbatim**

1. Shtetet Anëtare miratojnë dhe zbatojnë akte ligjore, nënligjore dhe administrative, të cilat janë të nevojshme për të përmbushur detyrimet ligjore të kësaj direktive përpara datës 19 korrik 2001. Shtetet Anëtare informojnë në lidhje me këtë Komisionin. Gjatë miratimit të këtyre masave, Vendet Anëtare përmendin lidhjen midis tyre dhe kësaj Direktive brenda masave në fjalë ose gjatë publikimit të tyre zyrtar. Metodën për bërjen e kësaj reference përcaktohet nga vendet anëtare.
2. Vendet Anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të ligjit vendas të cilat i miratojnë në fushën e rregulluar nga kjo direktivë.

**Neni 14**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo direktivë hyn në fuqi ditën kur publikohet në *Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Evropiane*.

**Neni 15**  
**Entitetet të cilave u drejtohet direktiva**

Kjo direktivë u drejtohet vendeve anëtare. Bruksel, më 13 dhjetor 1999.

*Për Parlamentin Evropian*

*Presidenti*

N. FONTAINE

*Për Këshillin*

*Presidenti*

S. HASSI

## SHTOJCA I

Kërkesat ligjore për certifikatat e kualifikuara

Certifikatat e kualifikuara duhet të përmbajnë:

- (a) një shenjë që të jetë lëshuar si certifikatë e kualifikuar;
- (b) identifikimin e ofruesit të shërbimit të certifikimit dhe vendin ku është themeluar;
- (c) emrin e nënshkruesit ose një pseudonim, që identifikohet si i tillë;
- (d) parashikimin që të përfshihet një atribut specifik i nënshkruesit nëse ka, në varësi të qëllimit për të cilin lëshohet ;
- (e) të dhënat verifikuese të cilat u korrespondojnë të dhënave krijuese të certifikatës të cilat janë në kontrollin e nënshkruesit;
- (f) fillimin dhe fundin e periudhës së vlefshmërisë së certifikatës;
- (g) kodin identifikues të certifikatës;
- (h) nënshkrimin elektronik të avancuar të ofruesit të shërbimit të certifikimit i cili e ka lëshuar;
- (i) kufizimet e objektit të përdorimit të certifikatës, nëse ka; dhe
- (j) kufizimet e vlerës së transaksioneve për të cilat mund të përdoret certifikata, nëse ka.

## SHTOJCA II

Kërkesat ligjore për ofruesit e shërbimeve të certifikimit të cilët lëshojnë certifikata të kualifikuara.

Ofruesit e shërbimeve të certifikimit duhet:

- (a) të tregojnë besueshmërinë e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të certifikimit;
- (b) të sigurojnë vënien në punë të një liste adresari të gatshëm e të sigurt dhe një shërbim revokimi të sigurt dhe të menjëhershëm;

- (c) të kujdesen që të përcaktohet me saktësi data dhe ora e lëshimit ose e revokimit të një certifikate;
- (d) të verifikojnë përmes mjeteve të duhura në përputhje me legjislacionin kombëtar, identitetin dhe, nëse ka, të gjitha atributet specifike të personit të cilit i lëshohet një certifikatë e kualifikuar;
- (e) të punësojnë punonjës të cilët zotërojnë njohuri dhe përvojë specialisti ku të plotësojnë kushtet e nevojshme për shërbimet e ofruara, sidomos aftësi në nivel drejtues, njohuri teknike në fushën e teknologjisë së nënshkrimeve elektronike dhe, njohuri në fushën e procedurave të duhura të sigurisë; të zbatojnë gjithashtu edhe procedurat administrative dhe menaxhuese të cilat të jenë të mjaftueshme dhe t'u korrespondojnë standardeve të pranuar;
- (f) të përdorin sisteme dhe produkte të besueshme, të cilat të jenë të mbrojtura nga ndryshimi dhe të ofrojnë siguri teknike dhe kriptografike të procesit të mbështetur prej tyre;
- (g) të marrin masa kundër falsifikimit të certifikatave dhe, në ato raste kur të dhënat krijuese të nënshkrimit i gjeneron ofruesi i shërbimeve të certifikimit, të garantojnë konfidencialitetin gjatë procesit të gjenerimit të këtyre të dhënave;
- (h) të mbajnë burime financiare të mjaftueshme për të punuar konform kërkesave të parashikuara në këtë Direktivë, sidomos për të përballuar rrezikun e mbajtjes së përgjegjësisë ligjore për dëmet, për shembull, përmes një kontrate të përshtatshme sigurimesh;
- (i) të regjistrojë të gjitha informacionet përkatëse në lidhje me një certifikatë të kualifikuar për një periudhë të përshtatshme kohore, sidomos me qëllim dhënien e provës së certifikimit në një proces ligjor. Këto regjistrime mund të mbahen në formë elektronike,
- (j) të mos mbajnë apo kopjojnë të dhëna krijuese të nënshkrimeve personit të cilit i ka ofruar shërbime menaxhimit kyç ofruesi i shërbimeve të certifikimit;
- (k) përpara lidhjes së një marrëdhënieje kontraktuese me një person i cili kërkon një certifikatë për të mbështetur nënshkrimin e vet ta informojnë këtë person

përmes një mjeti të qëndrueshëm komunikimi në lidhje me termat dhe kushte e sakta për sa i takon përdorimit të certifikatës, përfshirë kufizimet e përdorimit të saj, ekzistencën e ndonjë skeme vullnetare akreditimit dhe procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe ankesat. Ky informacion, që mund të transmetohet në mënyrë elektronike, duhet të jepet me shkrim dhe në një gjuhë të kuptueshme. Gjithashtu, u duhet dhënë sipas kërkesës së palëve të treta, të cilat mbështeten te certifikata, pjesët përkatëse të këtij informacioni;

(l) të përdorin sisteme të besueshme për ruajtjen e certifikatave në formë të verifikueshme në mënyrë që:

- regjistrimet dhe ndryshimet të mund t'i bëjnë vetëm personat e autorizuar,
- të mund të kontrollohet vërtetësia e informacionit,
- certifikatat të jenë në dispozicion të publikut vetëm në ato raste kur është marrë pëlqimi i titullarit të certifikatës dhe,
- çdo ndryshim teknik i cili komprometon këto kërkesa ligjore për sigurinë, të jetë i dukshëm në sytë e operatorit.

### **Shtojca III**

Kërkesat për pajisjen e sigurisë së krijimit të firmave

1. Pajisjet për sigurinë e krijimit të firmave, me anë të masave të duhura teknike dhe procedurale, duhet të paktën të sigurojnë që:

(a) e dhëna për krijimin e nënshkrimit të përdorur në gjenerimin e saj të përdoret vetëm një herë, dhe të sigurohet fshehtësia e saj në mënyrë të përshtatshme;

(b) e dhëna për krijimin e nënshkrimit të përdorur në gjenerimin e saj nuk mundet që, me sigurimin e duhur, të nxirret dhe që firma të mbrohet nga falsifikimi me anë të teknologjisë së tashme;

(c) e dhëna për krijimin e nënshkrimit të përdorur në gjenerimin e saj të mbrohet në mënyrë të përshtatshme nga nënshkruesi i saj ndaj përdorimit të së tretëve.

2. Pajisjet për sigurimin e krijimit të nënshkrimit nuk duhet të ndryshojnë të dhënat për nënshkrim ose të ndalojnë shfaqjen e këtyre të dhëna nënshkruesit para procesit të nënshkrimit.

#### **Shtojca IV**

Rekomandimet për verifikimin e sigurimit të firmës

Gjatë procesit të verifikimit të firmës duhet sigurohet me sigurinë e përshtatshme që:

(a) e dhëna e përdorur për verifikimin e firmës përputhet me të dhënë të shfaqur nga verifikuesi;

(b) firma vërtetohet me siguri dhe rezultati i verifikimit shfaqet në mënyrë të saktë;

(c) verifikuesi mundet, sipas nevojës, të provojë me siguri brendinë e të dhënës së nënshkruar;

(d) vërtetësia dhe vlefshmëria e certifikatës së kërkuar në kohën e vërtetimit të nënshkrimit të vërtetohen në mënyrë të sigurt;

(e) rezultatet e verifikimit dhe identiteti i nënshkruesit të shfaqen në mënyrë të saktë;

(f) përdorimi i pseudonimit tregohet qartë; dhe

(g) çdo ndryshim me rëndësi për sigurinë të mund të fshihet.